



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt.10.03.2023]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT¹)

OPERATORIT EKONOMIK “BESNIK MEÇI” PF

Adresa: Tirane Kashar Autostrada Tirane-Durres, Km.5, Godine nje kateshe perballe QTU-se.

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedure e hapur” ”Marrëveshje kuadër” (mall) me disa operatorë ekonomikë **1 (një) operator ekonomik fitues për secilin lot.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti i parë: ”Blerje pjesë këmbimi goma” me Nr. REF-55511-12-29-2022**

Publikimet e mëparshme (njoftimi i kontrates): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 179 datë 30 Dhjetor 2022

Publikimet e mëparshme (njoftimi i fituesit paraprak): Buletini Nr. 21 datë 6 Mars 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

- **Operatori ekonomik “Besnik Meci” pf me NUIS L12407012R**

Vlera e ofruar pa tvsh =**15.784.800** (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë.

- **BOE “Gajdi Company” shpk & “Servis Auto 2000” shpk me NUIS K79631501Q dhe NUIS K31523078F**

Vlera e ofruar pa tvsh =16.384.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë.

- **Operatori ekonomik “Sparkle 32” shpk me NUIS L51327014R**

Vlera e ofruar pa tvsh =0 (zero) lekë

Janë s’kualifikuar Operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. **BOE “Gajdi Company” shpk & “Servis Auto 2000” shpk me NUIS K79631501Q dhe NUIS K31523078F.**

Për arsyet si më poshtë vijon:

Prokurimin Publik”dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

AK në kriteret për kualifikim pika 2.3.4 dhe 2.3.5 ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që disponon Licence për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1.

2.3.5 Operatori ekonomik të jetë i pajisur me leje mjedisore Tipi C, kodi III.1 A

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi gjatë shqyrtimit të ofertës së paraqitur nga BOE “Gajdi Company” shpk & “Servis Auto 2000” shpk se operatori ekonomik “Gajdi Company” shpk në partneritet me operatorin ekonomik “Servis Auto 2000” shpk nuk ka paraqitur Licencë për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1. dhe as leje mjedisore Tipi C, kodi III.1 A. Ky kriter është plotësuar vetëm nga operatori ekonomik “Servis Auto 2000” shpk. Referuar aktmarrëveshjes për bashkim të përkohshëm operatori ekonomik “Gajdi Company” shpk ka marrë përsipër të realizojë 92% të objektit të kontratës edhe operator

ekonomik “Servis Auto 2000” shpk të realizojë 8% të objektit të kontratës. Në VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 3 përcaktohet se:

“ *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

Në mbështetje të dispozitës ligjore sa më sipër cituar operatori ekonomik “Gajdi Company” shpk duhet të plotësonte kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 .

Marrë shkas nga aktiviteti i këtij operatori ekonomik si edhe nga fakti që ky operator do të kryejë 92% të të gjithë kontratës pra pjesën më të madhe të furnizimit të mallrave apo edhe të realizimit të shërbimeve lidhur me këto mallra sikundër është edhe **”Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave”** duhet domosdoshmërisht që operatori ekonomik ”Gajdi Company” shpk për pjesën e partneritetit të marrë përsipër të disponojë licensat sipas përcaktimeve të bëra në pikat 2.3.4 dhe 2.3.5.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80 , neni 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 79, neni 80, neni 82 **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Sparkle 32” shpk me NUIS L51327014R

Për arsyet si më poshtë vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Neni 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si mëposhtë:

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Operatori Ekonomik **“Sparkle 32” shpk** nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, dokumentacionin e duhur ligjor, ekonomik dhe teknik. Ka paraqitur vetem Bilancin e vitit 2021 edhe ISO 14001-2015. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e dokumentacionit ekonomik, ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik Komisioni i

Vlerësimi të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomik “**Sparkle 32**” shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë te pavlefshme.**

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si operator ekonomik i suksesshem i procedurës së prokurimit

- **Operatori ekonomik “Besnik Meci” pf me NUIS L12407012R**

Vlera e ofruar pa tvsh =**15.784.800** (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____